



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M
Nr. 67, datë 30.10.2017

**PËR MIRATIM E SHITJES TË MJETEVE TË TRANSPORTIT ME PROCEDURË
ANKANDI PUBLIK**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 30.10.2017 mbështetur në nenet 9 pika 1.2 germa 'a', 'c', neni 54 germa 'e', 55 pika 4 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore", ligjin nr.10296 datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, dt. 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" të ndryshuar, ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.9874 dt.14.02.2008 "Për ankandin publik" të ndryshuar, VKM Nr.1719 dt.17.12.2008 "Për miratimin e rregullave te ankandit publik", të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, me 34 vota pro,

V E N D O S I

1. Miratimin e shitjes të mjeteve të transportit me procedurë ankandi publik për skrap (28 mjeteve të transportit) të nxjerra jashtë përdorimi sipas të dhënave të Tabelës 1 bashkëlidhur.
2. Miratimin e shitjes së mjeteve të transportit me procedurë ankandi publik (3 mjetet e transportit), sipas të dhënave të Tabelës 2 bashkëlidhur.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.10.2017
Shpallur në datën 31.10.2017

Sekretar i këshillit

Suel Hadri

KRYETAR

Xhemal BUSHATI